



STATUTI

I SHOQERISE

“Réseau des Chambres des Experts Européens Département Afrique de L’Ouest” (R.C.E.E.D.A.O)
SH. P. K.

Me cilesine e Ortakut te Vetem themelues:

Z. Marco SANGUINETI, atësia Angelo, i datelindjes 28. 10. 1946, lindur ne Chiavari (GE) Itali dhe banues ne Itali, Corso Andrea Podesta’ 6/1 Genova, mbajtes i Pasaportes Italiane Nr.YA8053900.
me vullnet të lirë e të plotë mbeshetur ne:

Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” te ndryshuar, Ligjin Nr. 131/2015 “Per Qendren Kombetare te Biznesit” me ndryshimet e mëvonshme, si dhe legjislacionin ne fuqi ka themeluar nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “Réseau des Chambres des Experts Européens Département Afrique de L’Ouest” (R.C.E.E.D.A.O) (me poshte e quajtur “Shoqeria”)

KREU I

NENI 1

KRIJIMI

Shoqëria është person juridik i të drejtës shqiptare, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

NENI 2

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB (Qendra Kombetare e Biznesit), në përputhje me kushtet e procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të treëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

NENI 3

SELINA

Shoqëria e ka selinë në Tirane, Tirane, Rr. Frosina Plaku”, Godina 9 kate, shk. 5, K. 3, ap. nr. 18 te regjistruar ne Zonen Kadastrale Nr. 8220, Pasuria Nr. 3/201 + 5 – 18.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hap zyra përfaqësie, legë, të krijojë filiale, si mënda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të Vetëm.

NENI 4

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

- Konsulence per qellime humanitare
- Konsulence nderkombetare (International Advisor).
- Studime te fizibilitetit dhe investigim te tregut per investime nderkombetare ne fushen e pasurive te paluajtshme dhe per qellime humanitare.
- Menaxhime projektesh (Project Manager) per programet e zhvillimit ne fushen e pasurive te paluajtshme dhe per qellime humanitare.
- Kerkim fondesh nga investitore private dhe jo vetem per qellime humanitare.

NENI 5

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, pa afat.

KREU II
KAPITALI



NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1.000 Euro dhe është i perbere nga 1 kuote e cila është kontribut dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm z. Marco SANGUINETI.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të perfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

NENI 7
ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga organi kompetent të një eksperti të autorizuar për këto kontribute.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim të Ortakut të Vetëm në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën dyzet e pesë dite para datës së mbledhjes së Ortakut të Vetëm të thirrur për të marrë vendimin rreth këtij projekti.

NENI 8
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në shoqëri vetëm me miratimin e Ortakut të Vetëm.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bankëshortëve.

Gjithashtu janë lirisht të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

KREU III
ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 9
ORGANI VENDIMARRËS

Ortaku i Vetëm është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Ortaku i Vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë, që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Ortaku i Vetëm brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit financiar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin, llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori, si dhe gjithcka tjetër që me ligj i takon atij.

Ai mund të perfaqësohet edhe nga një tjetër person nëpërmjet një prokure.

NENI 10
NDRYSHIMET E STATUTIT

Ndryshimet e statutit vendosen nga Ortaku i Vetëm.

Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë Qendres Kombëtare të Biznesit.

NENI 11
ADMINISTRIMI

Administrator i Vetem i Shoqerise eshte emeruar z. Marco SANGUINETI.

Administratori ushtron funksionin e tij per nje periodhe kohe 5 vjecare qe nga momenti i emerimit, me te drejte riemerimi.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Ortakut të Vetëm të shoqërisë.

NENI 12

KOMPETENCAT

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave, që ligji ia jep shprehimisht Ortakut të Shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve, që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve, kur ajo provon se të tretët e dinin, që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Administratorit nuk i lejohet të marre hua te shoqëria, të jape pëlqimin në emer të saj për paradhënie si dhe të bëhet dorëzënës ndaj të tretëve. Ne rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

Klauzolat e këtij statuti, që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

NENI 13

PERGJEGJESITE

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statusit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga ortaku i vetem qe i sjellin dem Shoqerise, i ngarkohen administratorit qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale pasojat perkatese.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaku ka te drejte te ngrene padjenale kund administratorit.

Ortaku ka te drejte te ndjeko ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit, qe i eshte shkaktuar shoqerise, përfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme.

Ortaku qe nuk eshte administrator, ka te drejte ne cdo kohe personalisht per veprimtarine e shoqerise dhe te njihet me llogarite dhe dokumentet e shoqerise.

NENI 14

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 01 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Përjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 15

BILANCI I SHOQERISE DHE I DIVIDENTIT

Brenda gjashte muajsh nga mbyllja e vitit financiar. Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar sic edhe parashikohet nga ligji.

NENI 16

EKSPERTET

Eksperti ka per detyre te kontrolloje te gjithë dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithë vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollët periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e Ortakut te Vetem.

Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si edhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ia paraqese e dorezoje ne kohe ortakut per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

NENI 17

Bilanci Kontabel vjetor miratohet mbi bazen e vendimit me shkrim nga Ortaku i Vetem, i cili jo vetem qe dokumenton miratimin e tyre por vendos ne lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave te zhvillimit te metejshem te shoqerise dhe garantimin e veprimtarise se rregullt te saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te veçante etj.

NENI 18

Te ardhurat neto (dividenti) qe mbeten pas veçimit te fondeve ligjore te mesiperme dhe te atyre per shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj te treteve, i mbesin dhe i kalojne ne pronesi, Ortakut te Vetem te Shoqerise.

NENI 19

Shperndarja ose prishja e Shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkakut, edhe para plotesimit te afatit per te cilen eshte krijuar sic mund te jene:

Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhdimit te metejshem te veprimtarise se saj.

Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"

Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Me vendim te Ortakut te Vetem.

Ne kete rast Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim ne te cilen parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 (nje) apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim".

NENI 20

BASHKIMI DHE NDARJA

Shoqeria me ane te bashkimit, mund t'i kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ajo themelon.

Bashkimi ose ndarja sjell prishjen pa likuidim te shoqerise qe zhduket, dhe kalimin e plote te trashegimise ne daten e realizimit per undimtar te operacionit. Bashkimi ose ndarja sjell njekohesisht per ortaket e shoqerive, qe zhduken marrjen e cilesise se ortakeve te shoqerive perfituese sipas kushteve te percaktuara ne kontraten e bashkimit ose ndarjes.

NENI 21

Afati i emerimit te likuidatorit, publikohet sipas kushteve qe parashikon ligji perkates duke specifikuar dhe dokumentat qe duhet depozituar ne Aneksin e QKB-se.

NENI 22

Likuidatori eshte i detyruar qe te jete i vemendshem dhe korrekt, si per realizimin e te drejtave per subjektet ndaj te cileve shoqeria eshte kreditore dhe per ekzekutimin e detyrimeve debive qe shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve te veçante apo personave fizik apo juridik vendas apo te huaj.

NENI 23

BAZA LIGJORE

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete akt dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut do te zbatohen dispozitat e ligjore ne fuqi.

NENI 24

MOSMARREVESHJET

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 25


DISPOZITA PERFUNDIMTARE

Ky statut u redaktua ne 4 kopje me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe (te cilit ju perktheje nga shqipja ne italisht nga perkthyesi i njohur prej meje dhe i pranuar prej tij z. Klodian Kovaci i cili deklaroi se perktheu sa me siper fjale per fjale nga shqipja ne italisht dhe nenshkroi kete akt ne fund) dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise, nenshkruhet ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen sipas ligjit.

Tirane me date 10.09.2019

ORTAKU I VETEM

Marco SANGUINETI


Marco Sanguineti

Klodian Kovaci



KLODIAN KOVACI
PERKTHYES I BETUAR
TRADUTTORE GIURATO
0698193399


REPubLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E NOTERISE
DEGA VENDORE TIRANE
NOTER ILIRJAN ISAJ
Bul "B Curri" P. 25, shk. 1, ap. 2 - Tirane
0682148021; e-mail: ilirjanisaj@yahoo.it
Nr. 3796 Repertori

VERTETIM NENSHKRIMI

Sot me date 10/09/2019, para meje Noterit Ilirjan Isaj u paraqit personalisht :

► I. Z. Marco Sanguineti shtetas italiane me pasaporte Italiane nr. ZA8053900, madhor me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i cili ne prani te perkthyesit te njohur prej meje dhe pranuar prej tij z. Klodian Kovaçi me deklaroi se sa me siper eshte nje statut i hartuar prej tij jashte kesaj zyre noteriale me vullnet te lire dhe te plote dhe mban nenshkrimin e tyre, une noteri e vertetoj nenshkrimin ne baze te Ligjit Nr. 110//2018 "Per Noterine".

NOTER



ILIRJAN ISAJ

A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Ilirjan Isaj", written over a faint circular notary stamp.